

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbime topografie për pasurite e sekuestruara dhe të konfiskuara” për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):
Shërbime Topografike: 71351810-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,994,020 (tre milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër mijë njëzetë)
Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet

të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar,

duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me Liçense profesionale (e vlefshme) në fushën e Gjeodezisë (leshuar nga MIE ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e Gjeodezisë), ku të përfshihen kategorite:

8. PROJEKTUES GJEODET:

- a- Rivelime inxhinierike.
- b- Rilevime inxhinierike kadastrale.
- c- Sisteme GIS.
- d-Bazamente gjeodezike.
- e- Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

Argumentimi: Kërkesa për pajisjen e operatorit ekonomik me licencën perkatese mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku percaktohet se: *“autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”*, në nenin 41, pika 4/ a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku percaktohet: *Për të provuar përshtatshmerinë për të kryer veprime profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës të leshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, parashikimeve të VKM Nr.759 datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyerjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar.*

Pasurite për të cilat kerkohet ky shërbim, janë pasuri me status juridik të vecantë dhe kërkojnë shërbime të specializuara teknike dhe ligjore në përputhje me ligjin 111/2018 “Për Kadastren”, ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara”, i ndryshuar, ligjit nr 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, Trafikimit, Korrupsionit dhe Krimeve të tjera nepermjet masave parandaluese kundër pasurive”.

Për sa me sipër kërkesa për licence profesionale, është e lidhur drejtperdrejt me objektin e shërbimit, është i domosdoshëm për të ushtruar dhe realizuar shërbimin në mënyrë të ligjshme dhe siguron që shërbimi do të realizohet sipas standarteve profesionale dhe teknike të kërkuara.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës/ave që lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, në përbërje të cilit të ketë të paktën 2 (dy) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- 2 (dy) Inxhinier Gjeodet / Topograf/ Gjeomatik

Në lidhje me stafin teknik të paraqitet:

- Diplomë me profil Inxhinier Gjeodet/ Topograf / Gjeomatik, CV dhe çdo dokument tjetër që vërteton eksperiencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 3 (tre) vite.
- Kontrate pune individuale.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit është vendosur duke marrë për bazë specifikimet teknike dhe termat e referencës të hartuara nga Autoriteti Kontraktor dhe ka për qëllim sigurimin e AK se operatori ekonomik zoteron kapacitetin profesional, me një staf teknik të kualifikuar për ta realizuar kontratën sipas specifikimeve teknike.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

Pervoja e stafit teknik garanton Autoritetin Kontraktor që operatori ekonomik do të kryejë shërbimin me kapacitet të lartë profesional si në matje në terren, përgatitjen e planeve të rievimit, në hartimin e dokumentacionit sipas kërkesave, verifikimin teknik dhe menaxhimin e të dhënave kadastrale. Eksperienca jo më pak se 3 vite lidhet me arsyetimin se shërbimet topografike kërkojnë njohuri të konsoliduara për realizimin e matjeve, njohjen e terreneve dhe problematikave të tyre si dhe njohuri me të mira në përdorimin e pajisjeve si dhe garanton kryerjen e punës me profesionalizëm duke respektuar afatet dhe kërkesat kontraktuale.

Kërkesa për minimisht dy inxhinierë me profil Inxhinier Gjeodet/ Topograf / Gjeomatik lidhet drejtpërdrejtë me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimit që do të realizohet dhe është i domosdoshëm për realizimin e shërbimit, për të garantuar cilësinë, profesionalizmin, saktësinë në matje, përpunimin e saktë të të dhënave, dhe një garanci që shërbimi do të realizohet nga persona me formimin dhe eksperiencën e duhur profesionale.

Numri i punonjësve të kërkuar më sipër është minimal dhe është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën, rëndësinë dhe vlerën e procedurës së prokurimit.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë pajisjet teknike të nevojshme për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi si më poshtë:

- GPS Gjeodezik;
- Total Station Robotik;
- Laser Scanner;
- Drone Gjeodezik;
- Licenca Software CAD;

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

-dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi.

Pajisjet e mesiperme garantojnë Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik do të sigurojë saktësi teknike në realizimin e shërbimit, saktësi teknike të matjeve topografike, saktësi në perpunimin e të dhenave kadastrale dhe përgatitjen e materialeve sipas kërkesave.

Nisur nga natyra teknike e shërbimit dhe kërkesave për realizimin e tij keto pajisje janë të domosdoshme, garantojnë realizimin e shërbimit sipas kërkesave të Autoritetit dhe janë në proporcion me llojin e procedurës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) automjet të cilin duhet ta ketë në pronësi, me qira ose në përdorim sipas rregullimeve ligjore. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- a. Akti që vërteton pronësinë ose Kontratë qeraje apo përdorimi (e vlefshme),
- b. Leje qarkullimi;
- c. Çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshëm);
- d. Sigurimin e detyrueshëm të mjetit (e vlefshëm);

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion të paktën një automjet në dispozicion për të përmbushur kontratën.

Kjo kërkesë konsiderohet e nevojshme për realizimin e shërbimit nisur nga fakti se objekt i kësaj procedure prokurimi është shërbimi i topografisë për matje në terren në zonë të ndryshme kadastrale në territorin e RSH-se, e cila përfshin transportin e stafit teknik dhe pajisjeve teknike në zonë të ndryshme sipas nevojave që do të ketë autoriteti në zonat që janë përcaktuar në procedurën e prokurimit.

Ky kriter synon të garantojë që operatori ekonomik ka kapacitetin minimal teknik dhe logjistik për të realizuar shërbimin në kohë dhe për të shmangur pengesat që mund të vijnë nga mungesa e transportit.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë çertifikatën të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar

akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

-SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Standarti **SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001:2015** është i nevojshëm pasi ndikon cilësinë e shërbimit, dhe garanton që operatori ekonomik zoteron një sistem të menaxhimit të cilësisë mbështetur në standarte ndërkombëtare. Zoterimi i këtij standarti është një garanci për realizimin e shërbimit me saktësi.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklarate** me anë të së cilës merr persiper të garantojë cilësi në shërbim, konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit dhe të të dhënave të vëna në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë bazohet në nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës, duke qenë se objekti i prokurimit përfshin shërbimin për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara të cilat janë pasuri me një status juridik të veçantë dhe kërkojnë shërbim të specializuar teknik dhe ligjor, pasuri të cilat janë objekt i hetimeve pasurore dhe penale, kërkesa për një deklaratë ku operatori merr persiper të garantojë konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit konsiderohet si një garanci për mbrojtjen e interesave të autoritetit kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT